



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 16.03.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti **AKK-DPKI-06-129/23**, për zyrtarin e lartë z. Halit Shabani, Dekan i Fakultetit të Biznesit në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, për shkak se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik, pasi që i njëjti ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të bordit të kompanisë “ECO-HIGJIENA” SH.P.K.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për z. Halit Shabani, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas pranimit të informatës nga jashtë se z. Halit Shabani krahas ushtrimit të funksionit publik profesor i rregullt në Fakultetin e Biznesit të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë (në vijim: UHZP) dhe njëkohësisht mban pozitën udhëheqëse dekan i këtij fakulteti, është edhe anëtar i bordit të drejtorëve në kompaninë “ECO-HIGJIENA” SH.P.K. në Gjiilan, e cila është themeluar sipas marrëveshjes së partneritetit publiko-privat.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) me shkresën zyrtare DPKI-06/02/234/23, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Halit Shabani, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë, me ç’rast z. Halit Shabani është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket dyshimit për konflikt të interesit, përkatësisht papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik. Gjithashtu është njoftuar se Agjencia do ta njoftoj për veprimet e mëtejme sapo të konstatoj nëse ushtrimi i pozitave si më lartë bie apo jo ndesh me dispozitat e LPKI-së.

Në takimin e mbajtur dhe përmes komunikimeve e dokumentacionit të dërguar në Agjenci, z. Halit Shabani ka sqaruar dhe ka paraqitur argumentet e tij sa i përket angazhimit të tij në bordin e drejtorëve në kompaninë “ECO-HIGJIENA” SH.P.K.

Me qëllim të sqarimit të këtij rasti, Agjencia ka kërkuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) informatat dhe historikun e biznesit për subjektin “ECO-HIGJIENA” SH.P.K. dhe subjektet tjera që janë aksionarë në këtë kompani, përfshirë marrëveshjen për themelimin e kësaj kompanie si partneritet publiko-privat dhe statutin e saj. ARBK-ja ka dërguar të gjitha informatat dhe dokumentacionin e kërkuar.

Agjencia ka analizuar me kujdes pretendimet e raportuesit të rastit, më pas dokumentacionin dhe informatat e siguruar sipas detyrës zyrtare, si dhe informatat, sqarimet dhe dokumentacionin që z. Halit Shabani ka dërguar në Agjenci, përfshirë aktet normative përkatëse të ndërmarrjes “ECO-HIGJIENA” SH.P.K. në Gjilan, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Sipas ekstraktit nga regjistri i deklaramit të pasurisë për vitin 2021, që z. Halit Shabani ka dërguar në Agjenci në muajin mars 2022, konstatohet se i njëjti është Dekan [Fakulteti i Biznesit në UHZP] dhe njëkohësisht Anëtar i Bordit [ndërmarrja “ECO-HIGJIENA” SH.P.K.] në Gjilan.

Sipas Marrëveshjes së partneritetit publiko - privat me nr. protokollin 348, e datës 28.05.2012, konstatohet se Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit (49%) dhe Kontraktuesi Moser Group, Dega Ecovision SH.P.K. (51%), kanë themeluar ndërmarrjen e përbashkët aksionare “ECO-HIGJIENA” SH.P.K. në Gjilan.

Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “ECO-HIGJIENA” SH.P.K., i datës 23.05.2012, në nenin 28 ka përcaktuar se Bordi i drejtorëve të kësaj ndërmarrjeje është njëri nga tre organet e saj, ndërsa në nenin 48 paragrafi 1, përcakton se shoqëria [“ECO-HIGJIENA” SH.P.K.] qeveriset nga Kuvendi i aksionarëve dhe nga Bordi i drejtorëve.

Me nenin 48 paragrafi 2 të Statutit si më lartë, është përcaktuar se Bordi i drejtorëve përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, tre (3) përfaqësues të partnerit privat “Ecovision” [Moser Group] dhe dy (2) nga Autoriteti Kontraktues [Komuna e Gjilanit]. Rrjedhimisht, Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes “ECO-HIGJIENA” SH.P.K., përbëhet nga tre anëtarë nga sektori privat dhe nga dy anëtarë nga sektori publik.

Sipas Vendimit nr. protokollin 917, i datës 14.12.2015, dhe sipas shkresës së datës 02.02.2023, të aksionarit Moser Group, konstatohet se ju jeni caktuar si anëtar i Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes “ECO-HIGJIENA” SH.P.K., për pjesën e sektorit privat përkatësisht për pjesën e aksionarit Moser Group - Ecovision.

Në vështrim të gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia erdhi në përfundim se z. Halit Shabani si zyrtar i lartë, përkatësisht Dekan i Fakultetit të Biznesit të UHZP-së, gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, në këtë rast anëtar (nga pjesa e sektorit privat) i Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes “ECO-HIGJIENA” SH.P.K., për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit

përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.

Andaj, përmes komunikimeve dhe korrespondencave, z. Halit Shabani është njoftuar për kufizimin dhe ndalesën ligjore si më lartë, si dhe është informuar për veprimet konkrete (masat) që duhet t’i ndërmerret për të shmangur gjendjen e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik. I njëjti ka premtuar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete, në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, z. Halit Shabani ka përcjellë në Agjenci komunikimin elektronik (e-mail) me të cilin e ka njoftuar përfaqësuesit e aksionarit privat të ndërmarrjes “ECO-HIGJIENA” SH.P.K., lidhur me kërkesën e Agjencisë dhe njëherit për dorëheqje nga bordi i drejtorëve të ndërmarrjes “ECO-HIGJIENA” SH.P.K., duke theksuar se, citoj: “[...] kam vendosur të dorehiqem nga anëtari i bordit të Ekovizionit [...] ju lutemi të pranoni dorëheqjen time dhe të me mirëkuptoni.”

Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia konstatoi se zyrtari i lartë z. Halit Shabani, ka dhënë dorëheqje nga pozita anëtar i Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes “ECO-HIGJIENA” SH.P.K., sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik. Me këtë rast z. Halit Shabani (deri sa mbanë pozitë të zyrtarit të lartë publik) nuk ka të drejtë që të ushtroj asnjë lloj detyre apo aktiviteti si anëtar i bordit të drejtorëve të subjektit si më lartë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Ylli Bulesllaku
Drejtör i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

